



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV
Sesioni pranveror

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike
Mbledhja nr. 14
Prishtinë, më 19 qershor 2012, në orën 10:00 salla N-10
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR MBIKËQYRJEN E FINANCIVE PUBLIKE

Në mbledhje morën pjesë: Ali Sadriu, Ramiz Lladrovci, Mursel Haljilji, Valbona Dibra, Armend Zemaj, Bali Muharremaj, Afrim Hoti, Adem Grabovci, dhe Albert Kinolli.

Të ftuar: z.Lars Lage OLOFSSON, auditor i përgjithshëm dhe z. Hysni Hoxha, drejtor i Organit Shqyrtues të Prokurimit.

Stafi mbështetës i Komisionit: Fatime Qorri – koordinatorë; Mehmet Simnica-zyrtar i fushës për ekonomi; Artan Venhari – KIPRED dhe Butrint Ymeri - praktikant.

Mbledhjen e kryesoi: Ali Sadriu - kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

1. **Miratimi i rendit të ditës;**
2. **Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 13.06.2012;**
3. **Shqyrtimi i Raportit të auditimit të pasqyrave vjetore financiare të OSHP-së. Të ftuar: z. Hysni Hoxha-OSHP dhe z. Lars Lage OLOFSSON, auditor i përgjithshëm.**

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, njëzëri miratoi rendin e ditës pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 13.06.2012

Kryetari konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, miratimin e procesverbalit të datës 13.06.2012 do ta bëjë në mbledhjen e radhës.

3. Shqyrtimi i Raportit të auditimit të pasqyrave vjetore financiare të OSHP-së

Kryetari – Raporti është hartuar nga ZAP, pas auditimit që i ka bërë OSHP-së. Hapi diskutimin.

Lagge Olofsson – Opinioni i auditimit është i kualifikuar, për arsye se kur i lexoni pasqyrat financiare, informacioni i dhënë në to, në disa aspekte, nuk është i vërtetë. Kjo ka të bëjë me rezultatin, i cili nuk është i drejtë dhe ka të bëjë me rrjedhjen e parasë së gatshme. Po ashtu, pasuritë nuk janë pasqyruar ashtu si duhet, si dhe menaxhimi financiar në OSHP, përveç progresit që është bërë gjatë këtij viti, tregon se ende ka hapësirë për përmirësim, sa i përket ndërtimit të sistemit të kontrolleve të mbrendshme.

Hysni Hoxha – OSHP-ja ka pasur kontakte edhe me MF-në, për të marrë një auditor të brendshëm. OSHP-ja është një institucion i vogël, i themeluar në gusht të vitit 2008 dhe ka një buxhet të vogël. Deri në vitin e kaluar, ka pasur vetëm 17 pozita të të punësuarve, mirëpo tani numri i punëtorëve është rritur në 20. OSHP-ja, deri më 30 qershor, do të bëjë implementimin e të gjitha të gjeturave të ZAP-it. Fillimisht, neni 12 i pasqyrave financiare në vend se shuma financiare të jetë 230,991 euro, është prezantuar vlera prej 253,008 euro. Pra, është prezantuar shuma totale e grandit, dhe jo shuma e mjeteve të shpenzuara. Dhe, ndryshimi mes 22,000 euro, mbetet i pashpenzuar. Ky është një gabim teknik dhe asnjë abuzim nuk është bërë me mjetet publike. Gjithashtu, sipas ZAP-it, në pasqyrat financiare nuk janë paraqitur të hyrat, edhe ky mund të konsiderohet si një gabim teknik, apo mungesë e njohurive për të plotësuar rubrikat adekuate. Lidhur me mospërputhjen e pasurive jofinanciare në vlerë mbi 1,000 euro, në mes pasqyrave financiare të prezantuara në shumën 62,822 euro, raporti të Sistemi i Menaxhimit të Financave në Kosovë (SIMFK), ku figuron shuma prej 57,801 euro, në pasqyrat financiare paraqitet një diferencë prej 5,021 euro, dhe kjo është bërë në mungesë të paraqitjes së këtyre të hyrave në kohë, si mungesë e stafit. Të hyrat nga depozitat dhe gjobat, të hyrat prej 152,000 euro, janë regjistruar në një kod ekonomik, prej tyre 63,000 euro gjoba dhe 89,500 euro, si depozita. Konfirmoj që e gjetura e ZAP-it në këtë rast është e vërtetë, pasi që OSHP-ja ka realizuar të hyra nga depozitat 117,500 euro, ndërsa nga gjobat 35,000 euro. Pra, këto janë bërë si rezultat i shënimit të tyre me një kod, si mungesë e njohurive të zyrtarëve të OSHP-së. Ndërsa, tani është bërë ndarja e kodeve të veçanta. Lidhur me rekomandimin për prokurim, një gjë e tillë ka qenë e evidente, por nuk është realizuar për vitin 2012, pasi që plani i prokurimit për vitin 2011, ka qenë i hartuar gabimisht. Shkelja që OSHP-ja ka shpërblyer operatorë ekonomikë, në mungesë të operatorëve ekonomikë, nuk qëndron, sepse dokumentet ku bazohet ZAP-i, janë dosje standarde dhe nuk ka qenë obligative, pasi që specifikimi teknik është hartuar dhe ka qenë i qartë, ndërsa nuk ka qenë e paraparë që operatorët ekonomikë të sjellin mostra apo katalogë për t'i verifikuar këto specifikime. Ka qenë një prokurim shumë modest, me vlerë prej 1,400 euro për toner. Lidhur me rekomandimin për auditimin, ju njoftoj se OSHP-ja nuk i plotëson kërkesat e ligjit për të themeluar një njësi të auditimit dhe ka kërkuar nga Ministria e Financave, që prej themelimit, ata të përfshijnë në kuadër të punëve të tyre edhe një auditor të brendshëm për OSHP-në, por deri më sot nuk është marrë asnjë vendim. Lidhur me rekomandimin për shfrytëzimin e automjeteve, ZAP-i ka konstatuar se nuk ka raport për shpenzimet e zyrtarëve të OSHP-së për automjete. Asnjë zyrtar i OSHP-së, nuk vozitet me mjete të OSHP-së, dhe për këtë ekziston një vendim.

Armend Zemaj – OSHP-ja, sipas ligjit dhe sipas nivelit, i takon nivelit të gjyqtarëve. Disa gjëra duhet të përmirësohen, dhe kjo mund të jetë si pasojë e mungesës së kapaciteteve të brendshme. Në OSHP nuk duhet të ketë mungesë të procedurave të prokurimit, pa marrë parasysh vlerën e kontratës. Lidhur me pagesat për punë shtesë për tërë stafin, pyeti: A janë bërë për tërë stafin apo vetëm për anëtarët që i shqyrtojnë lëndët?

Ramiz Lladrovci – Auditori ka bërë shumë vërejtje. Menaxhimi jo i mirë i financave publike, pagesa shtesë e punëtorëve, hartimi jo i mirë i planit të prokurim etj. janë disa shkelje që i ka

gjetur auditori. Kryetari i OSHP-së e pranoi që stafi i tyre është i pakualifikuar. Kjo nuk guxon të ndodhë, pasi që stafi duhet të jetë i kualifikuar dhe t'i përgatisë pasqyrat financiare, ashtu siç kërkohet, në mënyrën më të mirë të mundshme. Ne si komision kemi përgatitur një listë të rekomandimeve që do t'i propozohen Kuvendit për OSHP-në, që do të obligohet që, për një afat të caktuar, OSHP-ja të kthejë një përgjigje.

Valbona Dibra - Në raportin e auditorit nuk ka komente të bashkangjitura, që do të thotë se OSHP-ja i ka pranuar të gjitha të gjeturat e këtij raporti. Pyeti: A ka marrë OSHP-ja ndonjë masë ndëshkuese ndaj stafit jo të kualifikuar, të cilët realisht kanë bërë që OSHP-ja të jetë në këtë gjendje?

Hysni Hoxha – Sa i përket pagesave për punë shtesë, pagesa është bërë për stafin mbështetës dhe të gjithë ata që hulumtojnë dhe nxjerrin të dhëna nga secila lëndë. Dëshmi për këtë është Raporti i punës për Kuvendin. Sa i përket kthimit të përgjigjeve brenda një intervali të caktuar kohor, OSHP-ja do ta bëjë këtë. Të gjeturat e auditorit nuk janë për të ndërmarrë masa, pasi që lëshimet janë bërë pa vetëdije dhe i është tërhequr vërejtja stafit për këto lëshime.

Ramiz Lladrovci – A mund të sjellë OSHP-ja, Komisionit apo ZAP-it, vendimin për pagesën shtesë që i ka bërë stafit?

Kryetari – Është dashur të sillen dokumentacione për të gjitha vendimet që i ka marrë OSHP-ja për pagesë shtesë të punëtorëve, për çështje të mosbarazimit të të hyrave, mos- hartimi i duhur i planit të prokurimit dhe të gjitha gjetjet tjera.

Agim Shaqiri- Zyrtar kryesor financiar në OSHP – Arsyeja pse tek pasqyrat financiare nuk janë evidentuar të hyrat, është një gabim me kodin e planit kontabël të thesarit, ku gjobat dhe donacionet janë shënuar në një kod. Po ashtu, nuk është bërë një ndarje e saktë edhe tek shpenzimet. Tek planifikimi i prokurimit, stafi nuk ka mundur të mbulojë të gjitha pozitat, pasi ka qenë një palnifikim jo i drejtë.

Kryetari – Në bazë të cilit nen, OSHP-ja ka paguar stafin civil deri në 40 orë shtesë në muaj? A ka OSHP-ja evidencën për punën jashtë orarit? A ka ndonjë dokument për këto vendime? Nëse analizohet mirë raporti, siç është punuar nga ZAP-i, këtu ka shumë keqpërdorime.

Hysni Hoxha - Këto vendime janë marrë në bazë të dizpozitave të Ligjit mbi shërbimin civil dhe Ligjit të menaxhimit të financave, me kërkesë të kryetarit që stafi të kryejë punë shtesë jashtë punëve që janë të parapara me kontratë. Të gjitha këto janë bërë për t'i mbuluar kërkesat e institucionit.

Ramiz Lladrovci – A ka OSHP-ja një listë të stafit, i cili ka përfituar nga paga/puna shtesë? Kryetari i OSHP-së pranoi se stafi është jo i kualifikuar! Pyeti: Cili është roli i kryetarit të OSHP-së si menaxher, nëse stafi mbështetës bën gabime dhe keqpërdor buxhetin?

Hysni Hoxha – Çdo gjë është bërë me vendim dhe arsyetim dhe kjo është faktike. OSHP-ja ka ndërmarrë masa kur është bërë vlerësimi i punëtorëve.

Albert Kinolli – Si e shpjegon OSHP-ja, që nuk ka një person përgjegjës, i cili menaxhon dhe monitoron përdorimin e automjeteve zyrtare, ndërsa ka 8 zyrtarë që paguhet për punë shtesë?

Hysni Hoxha – Që nga themelimi, OSHP-ja ka pasur mungesë të zyrtarëve dhe të gjitha këto lëshime teknike kanë ndodhur për shkak të mungesës së stafit, ndërsa në disa raste si rezultat i njohurive jo të mjaftueshme të stafit.

Lagge Olofsson – Arsyeja pse Raporti nuk ka komente është se OSHP-ja dhe ZAP-i janë pajtuar

në të gjitha të gjeturat. Pra, kemi opinione të ndryshme se çka duhet të bëjmë për ato të gjetura. Për sa i përket pagesës jashtë orarit, është bërë për 11 muaj për të gjithë stafin. Gabimet teknike në pasqyrat vjetore financiare, tek shpalosjet e pasurive, sigurisht këto do të ndryshojnë në pasqyrat 9 mujore financiare, që do të përgatiten në fund të shtatorit. Sa i përket pagesave jashtë orarit, ligji lejon një gjë të tillë. Por, nëse të gjithë punojnë në të njejtën kohë jashtë orarit, kjo nuk është më punë jashtë orarit, por është një pagë shtesë. OSHP-ja tashmë nuk vepron më kështu dhe kjo është gjë e mirë.

Ramiz Lladrovci – Pyeti auditorin e përgjithshëm, nëse gjatë auditimit kanë parë një listë të nënshkrimeve për personat që kanë marrë pagë shtesë?

Lagge Olofsson– Sigurisht se ZAP-i dhe auditorët që janë marrë me auditimin e OSHP-së, kanë vërtetuar më parë faktet e prezentuara në raport, përderisa nuk ka në raportin e ZAP-it komente të bashkëngjitura, OSHP-ja kanë rënë dakord me auditorët.

Kryetari – Nëse ZAP-i i ka parë ato dokumente, është dashur të prezantohen para Komisionit. Ndërkohë, Komisioni do të bëjë disa rekomandime që ta obligojë OSHP-në që, brenda 4 muajve, të reflekton të gjeturat e paraqitura në raport.

Kryetari konstatoi se, Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, njëzëri ka vendosur që Kuvendit t'ia paraqesë këtë

REKOMANDIM

1. **Obligohet Organi Shqyrtues i Prokurimit Publik që:**
 - Të bëjë vetëvlerësim të menaxhimit financiar dhe të kontrollit, sipas instruksioneve të Ministrisë së Financave.
 - Në raportin nëntëmujor financiar, të pasqyrojë tabelat e harmonizuara financiare dhe regjistrimin e saktë të pasurisë.
 - Të dorëzojë në Komisionin për Mbikëqyrjen e Financave Publike, raport të detajuar, lidhur me pagesat e bëra për punë jashtë orarit. Raporti duhet të përmbajë bazën ligjore të pagesave, arsyeshmërinë e pagesave dhe veprimet e ndërmarra lidhur me këtë të gjetur.
 - Të sigurojë auditor të brendshëm.
 - Ta harmonizojë planin e prokurimit me buxhetin e ndarë.
 - Të dorëzojë Planin e Veprimit, lidhur me të gjeturat e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm.
2. **Obligohet Organi Shqyrtues i Prokurimit Publik, që në afatin prej katër muajve, me raport me shkrim ta njoftojë Kuvendin, përmes Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike, për veprimet e ndërmarra lidhur me këto rekomandime, si dhe me të gjeturat e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm.**
3. **Arsyetimin e Rekomandimit do ta paraqesë kryetari i Komisionit, z. Ali Sadriu.**

Mbledhja përfundoi në orën 11:10.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit

— Ali Sadriu —